# Republika e Kosovës
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
728/20
Datum. 04.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

---

**PSH.nr.728/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “CTA” sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Gama Ing” sh.p.k.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”*, me nr. të prokurimit: 613-20-2368-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Lipjan, me datën: 28.10.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. <u>APROVOHET</u>**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NNP “CTA” sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”*, me nr. të prokurimit: 613-20-2368-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Lipjan.

**II. <u>ANULOHET</u>**, në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull *“Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”*, me nr. të prokurimit: 613-20-2368-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Lipjan dhe nëse AK ende ka interes për këtë aktivitet te prokurimit, të njëjtin mundet ta **Ri-tenderoj.**

**III.** Organi Shqyrtues i Prokurimit **do ta njoftoj KRPP-në**, pasi qe zyrtari i Prokurimit te KK Lipjan nuk ka kërkuar nga Operatoret ekonomik vazhdimin e validitetit te Ofertave.

**IV.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**V.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**VI.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NNP “CTA” sh.p.k-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik NNP "CTA" sh.p.k-Prishtinë që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik NNP "CTA" sh.p.k-Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.09.2020 me nr. 728/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Gama Ing" sh.p.k.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *"Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan"*, me nr. të prokurimit: 613-20-2368-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6, 7, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 31 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Komuna e Lipjanit gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit te ofertave. Fillimisht AK me datë 14.07.2020, ka rekomanduar për kontratë OE N.P.N "Alping & Arbëri –NS " sh.p.k- Hajvali, pastaj pas vendimit PSH.nr.484/20, dhe rivlerësimit të ofertave AK me datë 11.09.2020 publikon vendimin dhe rekomandon për kontratë OE "Gama Ing" sh.p.k. Kundër të njëjtit vendim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Lipjanit, sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit të datës 23.09.2020, ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues dhe ka vërtetuar vendimin e datës 11.09.2020 për dhënie të kontratës.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) NNP "CTA" Sh.p.k

Parashtruesi i ankesës OE NNP "CTA" Sh.p.k, përveç kontestimit të arsyetimit të eliminimit pas ri vlerësimit të ofertave i konteston edhe ofertat e OE tani të rekomanduar "GAMA ING" SHPK, OE NPN "ALPING & ARBERI-NS" SHPK. Ku, OE ankues potencon se pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës

kundrejt pretendimeve ankimore rezulton që AK – Komuna Lipjan nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së per arsyet e poshtë shenuara:

Pretendimi ankimor lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht pikat sikur në ankesë. Më tej, OE ankues shton se AK ka kërkuar informata shtesë në bazë të vendimit të OSHP-së lidhur me certifikatat që ka lëshuar kompania AQSCERT. AK ka kërkuar informata shtesë lidhur me kompaninë AQSCERT për punëtorët e certifikuar: SELIM MALOKU, NAIM THAQI ARTON THAQI kanë certifikata nga kompania AQSCERT. Kompania AQSCERT ka dërguar programin për çfarë është e akredituar. AQSCERT është e akredituar si organizatë për sistemin e menaxhimit dhe sigurinë dhe shëndetin në punë. Nuk është qendër e licencuar për aftësim profesional siç është kërkuar në dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë. D.m.th. OE nuk e plotëson as këto kushte të kërkuara nga AK, ku AK nuk e ka eliminuar për këtë kërkesë.

- Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të ri vlerësimit të komisionit ri vlerësues, OE NPN ALPING DHE ARBERI-NS SHPK është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të pershkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 11.09.2020. Konkretisht i njejti OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të të njetit OE eshte i pa nenvojshem në këtë fazë.

2. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë "GAMA ING" SHPK, nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht pikën h) Min. një punëtor i certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit. OE ankues shton se OE i rekomanduar në listën e stafit si punëtor për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit ka dorëzuar certifikatën me nr. AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, ku shkruan se z. Florin Imeri është aftësuar si koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Pra, OE ankues potencon se OE i rekomanduar ka dështuar në plotësimin e kushtit të kërkuar nga AK për një punëtor të certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit.

- Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të certifikatës me numër AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, sqaron se z. Florin Imeri ka marrë pjesë dhe ka kaluar me sukses testin final në trajnimin "Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", ku në mesin e temave kryesore të trajtuara ishin "përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kantier me synim rritjen e sigurisë në punë", si dhe tema tjera. Prandaj, ne vlerësojmë se certifikata e tillëë e mbulon kerkesën e AK-se. Rrjedhimisht, pretendimin ankimor e kualifikojmë si të pa bazuar.

4. Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional 9.1dhe 9.2, konkretisht pikën b për inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master, ku OE i rekomanduar për kontratë në listën e stafit si menaxher me vendim ka emëruar arkitektin Petrit Qarkagjiu CV e arkitektit në dosje të tenderit është e pa nënshkruar nga vet inxhinieri.

-Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të kërkesës së dosjes së tenderit dhe CV-së së arkitektit Petrit Qarkagjiu, sqaron se në mesin e kërkesave të dosjes së tenderit ka qenë që "për stafin profesional nga pika A deri G të dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri ". Pra, CV e inxhinierit të arkitekturës së OE të rekomanduar nuk është e nënshkruar konform kërkesës së FDT-së. Megjithatë, sipas nenit 38, par 9 të RrUOPP-së, AK mund të kërkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimit për situatë të tillë, (AK- përgjat ri vleresimit nuk e ka bere nje gje të tille), prandaj këte pretendim ankimore e kualifikojme si të bazuar.

Prove se bashku me raport gjeni CV- e ing. z.Petrit Qarkagjiu.

5. Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Osman Vitia në lëmin e ngrohjes ka dorëzuar diplomë të shkollës së mesme dhe nuk ka dorëzuar certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

- Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe diplomës së punëtorit Osman Vitia, sqaron se në këtë diplomë ceket Osman Vitia ka kryer shkollën e mesme të lartë profesionale, profili arsimor "montues i aparatit të nxemjes qëndrore". Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo diplomë është e shkollës së mesme profesionale është ekuivalente me kërkesën e AK-së. Për më tepër AK me rastin e ri vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkëngjitur certifikatën shtesë për punëtorin Osman Vitia, certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit professional. Pra, punëtori Osman Vitia ka përfunduar me sukses kursin "Instalues i ngrohjes qendrore". Andaj, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbush kërkesën e AK-së dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

  Si provë bashkangjitur me raport, gjeni certifikatën për punëtorin Osman Vitia.

6. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues, murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Arben Selimi në lëmin e hidroteknikës ka dorëzuar certifikatat në lëmin e ujësjellësit, d.m.th. nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK sepse mungon profili i kanalizimit dhe nuk e përmbush kërkesën në lëmin e hidroteknikës.

- Eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK në mesin e 8 punëtorëve ka kërkuar një punëtor të licencuar të hidroteknikës, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar punëtorin z. Arben Selimi dhe për të njëjtin është bashkangjitur një certifikatë për ujësjellës të lëshuar nga "Shkolla e Zanatit" në Mitrovicë dhe një certifikatë për zjarrfikës, të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike e Kosovës. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkangjitur certifikatën shtesë për punëtorin Arben Selimi, certifikatë e cila është lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit professional, ku Arben Selimi ka përfunduar me sukses trajnimin instalues i ujsjellsit dhe kanalizimit. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbushë kërkesën e AK-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.
  Prove bashkangjitur me raport, gjeni certifikaten për punëtorin Arben Selimi.

7. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht kërkesën 3 që ka të bëjë me listën e pajisjeve teknike, ku është kërkuar të dëshmohet lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, kurse për automjetet që nuk regjistrohen duhet deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen duhet librezat e qarkullimit me validitet... dhe për këtë kërkesë, OE ankues potencon se OE i shpallur fitues në listën e pajisjeve ka dorëzuar kamionin Mercedes Atego 01-975-MR Kipper me validitet të regjistrimit deri me datë 17.06.2020, kurse hapja e tenderit është bërë me datë 19.06.2020 d.m.th. ky kamion nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK pasi që nuk ka validitet.

- Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e paisjeve teknike, ku perveç paisjeve tjera ka pershkruar gjithsej tre (3) kamion, ku dy nga ta në rastin e ofertimit kishin validitet për qarkullim rrugor. Për më tepër, eksperti shqyrtues sqaron se AK tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe professional, konkretisht në pozicionin b, ka kërkuar "Kamion min (2 copë)", rrjedhimisht OE i rekomanduar për dhënie e ploteson kërkesën e AK-së për dy kamion, pasi që afati i

fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 19.06.2020, kurse OE i rekomanduar në listën e pajisjeve ka pasur "kamion Scani kiper dhe me targa 01-928-NF me regjistrim deri me datë 13.09.2020" dhe "kamion Volvo kiper me dy koka dhe me targa 01-968-HN me regjistrim deri me datë 09.07.2020". Pra, edhe pse kamioni "Mercedes Atego 01-975-MR Kipper" nuk ka pasur regjistrim, dy kamionët e cekur si më lartë e përmbushin kërkesën e AK-së që është "Kamion min (2 copë)".

Si provë së bashku me raport gjeni kopjet e librezave të kamionëve si dhe marrëveshjen për shfrytëzim të komionit.

8. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP"CTA"SHPK, se është eliminuar nga AK me arsyetimin se tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht te stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktiv, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues **duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës**. Si dhe arsye e dytë e eliminimit nga AK është se tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional që ka të bëjë me licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar, e cila është vërtetuar edhe ņë mendimin e ekspertit dhe vendimin e OSHP-së gjatë periudhës sa ka qenë lënda në OSHP.

- Eksperti shqyrtues sqaron se AK tek kërkesa 2 e pikës 9.1&9.2 të dosjes së tenderit, në mënyrë specifike ka kërkuar:

  "*Kerkesa 2. Stafi Profesional a) Min. Nje Inxhiner i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeqar ose master, **Te caktohet edhe si menagjer per kete projekt**,*"

  Kurse, OE ankues si menaxher të projektit e ka caktuar Zija Morina me kualifikim **inxhinier i kualifikuar i ndërtimtarisë, dega ndërtimtari, drejtimi konstruktiv**, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës nuk ka caktuar si menaxher të projektit inxhinierin e arkitekturës siç është kërkuar nga AK.

9. Pretendimet tjera ankimore kanë të bëjnë me arsyetimin e eliminimit pas ri vlerësimit të ofertave kundrejt parashtruesit të ankesës.

- Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit që ka të bëjë me licencën e gjeodetit, ky pretendim eshte trajtuar përmes raportit paraprak të ekspertizës, rrjedhimisht paneli shqyrtues përmes vendimit PSH.nr.484/20 e ka gjjykuar, ku është potencuar se: "*OE edhe tani ankues, ka ngarkuar licencen e gjeodetit z.Muzafer Mustafa ne plateformen e – prokurimi, ku kjo licence ishte dhene me daten 27.03.2024, me afat skadimi 25.03.2019, kurse perms ankese se parashtruar OE ankues ka bashkangjitur licencen e pot e njejti gjeodet, me dat te dhenjes 27.03.2019, dhe me afat skadimi 25.03.2024*", pra pretendimi i ankuesit ishte kualifikuar si i pa bazuar.

10. Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues NNP"CTA"SHPK, ku cek dispozitat e nenit 31të

RRUOPP-së që kanë të bëjnë me validitetin e e ofertave .

Fillimisht sqarojme se parashtruesi I ankeses perms kerkeses per ri shqyrtim e ka kontestuar rekomandimin për dhenie të kontrates i dates 11.09.2020.AK/ Komuna Lipjan ka aprovu kerkesen e dates 15.09.2020, dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se operatoreve ekonomik nuk i është kerkuar vazhdimi i validitetit dhe sigurimi i ofertave. Pastaj, OE ankues perseri e ka kontestuar propozimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të dates 21.09.202, përms kerkeses për ri shqyrtim. AK, me daten 23.09.2020, aprovon kerkesen për ri shqyrtim dhe lë në fuqi vendimin e dates 11.09.2020, për dhenie të kontratës.

- Eksperti shqyrtues sqaron se AK, me daten 22.09.2020 (rreth 5 dite pas skadimit të ofertave) ka kerkuar nga operatoret ekonomik zgjatjen validitetit dhe sigurimit të tenderit. Sipas nenit 31, të RrUOPP-se, AK-te jane të obliguara që para dates së skadimit të kerkojne nga ofertuesit zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të tenderi.

Përfundimisht, bazuar në ate qe u pershkrua me larte eksperti shqyrtues rekomandon AK – Komuna Lipjan, që këte aktivitet të prokurimit ta anuloj në teresi pasi që OE-te pjesemarres në kete procedure të prokurimit nuk jane trajtuar në menyre të drejt sipas parimeve të Prokurimit Publik, rrjedhimisht përveq mos respektimit të procedures nuk janë respektuar në teresi edhe dispozitat e LPP-së, përkatesisht nuk është respektuar nenit 7, 59, i LPP-së.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar. Te anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK, ende ka interes te njëjtin ta **RI TENDEROJ**.

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 09.10.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtese nga OE:

**Ti bashkangjiten kjo shkres lendes me nr: 728/20**

Te nderuar/a,

Se pari dua të ju informoj se **ESH** nuk e ka trajtuar lëndën në përputhje me të drejtat dhe obligimet e veta që ia jep ligji i prokurimit dhe rregullorja e **OSHP-së**. Arsyeja pse mendojmë ashtu është i ka favorizuar dhe

plotesuar gabimet e **OE** te shpallur fitues që si veprime janë në kundërshtim me përgjegjësit dhe të drejtat e veta.

Pretendimi 8,9

Mendimi ESH

8. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP"CTA"SHPK, se është eliminuar nga AK me arsyetimin se tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht te stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktiv, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues **duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës**. Si dhe arsye e dytë e eliminimit nga AK është se tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional që ka të bëjë me licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar, e cila është vërtetuar edhe në mendimin e ekspertit dhe vendimin e OSHP-së gjatë periudhës sa ka qenë lënda në OSHP.

- Eksperti shqyrtues sqaron se AK tek kërkesa 2 e pikës 9.1&9.2 të dosjes së tenderit, në mënyrë specifike ka kërkuar:

  "*Kerkesa 2. Stafi Profesional a) Min. Nje Inxhiner i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeçar ose master.* ***Te caktohet edhe si menagjer per kete projekt,***"

  Kurse, OE ankues si menaxher të projektit e ka caktuar Zija Morina me kualifikim **inxhinier i kualifikuar i ndërtimtarisë, dega ndërtimtari, drejtimi konstruktiv**, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës nuk ka caktuar si menaxher të projektit inxhinierin e arkitekturës siç është kërkuar nga AK.

9. Pretendimet tjera ankimore kanë të bëjnë me arsyetimin e eliminimit pas ri vlerësimit të ofertave kundrejt parashtruesit të ankesës.

- Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit që ka të bëjë me licencën e gjeodetit, ky pretendim eshte trajtuar përmes raportit paraprak të ekspertizës, rrjedhimisht paneli shqyrtues përmes vendimit PSH.nr.484/20 e ka gjykuar, ku është potencuar se: "*OE edhe tani ankues, ka ngarkuar licencen e gjeodetit z.Muzafer Mustafa ne plateformen e - prokurimi, ku kjo licence ishte dhene me daten 27.03.2024, me afat skadimi 25.03.2019, kurse perms ankese se parashtruar OE ankues ka bashkangjitur licencen e pot e njejti gjeodet, me dat te dhenjes 27.03.2019, dhe me afat skadimi 25.03.2024*", pra pretendimi i ankuesit ishte kualifikuar si i pa bazuar.

I kujtojmë **ESH** dhe **PANELIT** se ne vendimin **PSHNR;506/20** kanë qenë kërkesat e njëjta nga **AK KK LIPJAN** dhe gabimi i njejtë i i **OE NNP''CTA''SHPK** ne tenderin me titull:Ndertimi i cerdhes se fëmijëve ne fshatin Gadime. për të cilin gjeni dëshminë ku keni aprovuar qe AK ka mundur të kërkoj informata shtesë konform nenit **59 dhe 72** .

Per keto dy pretendime **ESH nuk e trajton fare ku te bashkangjitur ka patur edhe vendimin me nr 506/20 .**

506/20
17.09.20

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH.nr.506/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NNP "CTA" shpk -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Engrup" SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime" me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan, më datën: 17.09.2020 , mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NNP "CTA" shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime" me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime" me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan, dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

[redacted]

: pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." -Prishtinë se autoriteti
s e ka eliminuar pa të drejt me arsyetimin se: "Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të
:apacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional licencën e gjeodetit e keni me
luar". Me tej, OE ankues shton se AK nuk ka respektuar Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për
Publik Neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe
ni shtesë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa e AK në njoftimin
te në piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: ka përcaktuar kërkesën 2. Stafi
l f) Një gjeodet bachelor apo master të jetë i pajisur edhe licence për matje gjeodezike,
kërkuar dokumentare; b) Për stafin profesional nga pika A. deri G. Të dëshmohen me CV të
nga vet inxhinieri, diplomat, Kontratat e punës ose para kontrata për ketë projekt, licenca për
validitet. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se siç po shihet AK
për anëtarin e stafit profesional gjeodet, për pos dokumentacionit tjetër dhe licenca për gjeodet

Pretendimi 3

Mendimi i ESH

2. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë "GAMA ING" SHPK, nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht pikën h) Min. një punëtor i certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit. OE ankues shton se OE i rekomanduar në listën e stafit si punëtor për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit ka dorëzuar certifikatën me nr. AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, ku shkruan se z. Florin Imeri është aftësuar si koordinator për sigurinë dhe



mbrojtjen e shëndetit në punë. Pra, OE ankues potencon se OE i rekomanduar ka dështuar në plotësimin e kushtit të kërkuar nga AK për një punëtor të certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit.

- Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të certifikatës me numër AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, sqaron se z. Florin Imeri ka marrë pjesë dhe ka kaluar me sukses testin final në trajnimin "Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", ku në mesin e temave kryesore të trajtuara ishin "përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kantier me synim rritjen e sigurisë në punë", si dhe tema tjera. Prandaj, ne vleresojme se certefikata e tillë e mbulon kerkesën e AK-se. Rrjedhimisht, pretendimin ankimor e kualifikojm si të pa bazuar.

# CERTIFIKATË TRAJNIMI

Nr. i Certifikatës AOS/T/S11002018

Emri i personit te trajnuar **Z. FLORIN IMERI Datelindja: 26.07.1966**
**INXHINIER I TEKNOLOGJISE DIP NR.652,date: 22-10-1990**

Mori pjesë dhe kaloi me sukses testin final në trajnimin si:

"KOORDINATOR PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT NË PUNË".

Temat e trajtuara ne trajnim:

Moduli 1: 40 orë: Sigurimi teknik i punonjësve dhe masat mbrojtëse në punë;
Moduli 2: 40 orë: Mbrojtja e shëndetit të punonjësve në punë;
Moduli 3: 40 orë: Vlerësimi i rriskut në punë.

- Dokumentacioni teknik dhe ligjor që plotësohet në kantier për sigurimin teknik të punonjësve. "Libri i sigurimit teknik"; "Libri i aksidenteve";
- Harmonizimi i skemës së sigurisë dhe mbrojtjes në punë të shoqërive zbatuese të punimeve të ndërtimit me kërkesat e Standartit OHSAS 18001:2007 ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune";
- Përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kantier me synim rritjen e sigurisë në punë;
- Përdorimi i pajisjeve të punës dhe pajisjeve të mbrojtjes personale të punëmarrësve sipas kërkesave të seksionit Nr.6 Aneksi II i VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";
- Hartimi i Planit Operativ të Sigurisë POS, për vlerësimin e rriskut të rrezikut të cilit i ekspozohen punonjësit gjatë punës në kantier, konform kërkesave të seksionit Nr.5 Aneksi II i VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";
- Masat suplementare në zbatimin e punimeve për punimet e vlerësuara me rrisk të lartë në planin operativ të sigurisë.
- Hartimi i dokumentacionit te vleresimit te riskut ne kompani.
- Raste praktike.

Datat e trajnimit 01/04 - 30/06/2018

Vendi i trajnimit, Tirane, Shqiperi untitled

Organizator i trajnimit AQSCERT shpk "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"

Data e lëshimit të certifikatës, Tirane 02/07/2018

Vlefshmëria e certifikatës mund të kontrollohet në www.aqscert.org/certifikata ime/trajnime, duke ndjekur udhëzimet që pasqyrohen aty.

AQSCERT For Certification Body

Trajnuesi

DOC FO-AOS-018

aqscert.org/akreditime/

AQSCERT

Kreu · Shërbimet · Punoni me Ne · Gjuhe:

## Riakreditim dhe Zgjerim i fushave te akreditimit.

AQSCERT ne fillim te vitit 2018 ka perfunduar me sukses riakreditimin e tij per standartet ISO 9001, ISO 14001, OHSAS 18001, ISO 13485, ISO 20000-1, ISO 27001 si dhe ka zgjeruar fushat e saj te akredituara per standartet ISO 22000 dhe ISO 50001

### Standardet ISO

CERTIFIKATA E AKREDITIMIT [ Shkarko]

CERTIFIKATA 9001 2015 [ Shkarko]

CERTIFIKATA 14001 2015 [ Shkarko]

CERTIFIKATA OHSAS 18001 2007 [ Shkarko]

ISO 50001 2011 [ Shkarko]

ISO 22000 2005 [Shkarko]

ISO 13485 2016 [Shkarko]

ISO IEC 27001 2013 [Shkarko]

ISO IEC 20000 1 2011 [Shkarko]

REPUBLIKA E SHQIPERISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DHE EKONOMISE

DA

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT

# ÇERTIFIKATË AKREDITIMI

**AQSCERT Sh.P.K.**

Rruga "Jusuf Vrioni", Pallati 1, hyrja 6, Tiranë

Numri i Rregjistrimit

CS 008

**Është akredituar si organizëm certifikues sistemi menaxhimi në përputhje me S SH ISO/IEC 17021-1:2015 "Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa për organizmat që kryejnë vlerësimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit".**

Kjo çertifikatë është e vlefshme e bashkëlidhur me Programin e Akreditimit

**Data e akordimit të akreditimit: 29.03.2018**

**Certifikata është e vlefshme deri më datë: 28.03.2022**

Drejtori i Përgjithshëm

**Armond HALEBI**

**Përgjigja jonë rrreth mendimit të pretendimit nr2** të **ESH**

Nuk pajtohemi me mendimin e ESH pasi që nuk e ka trajtuar drejt sipas LPP-së

sepse **KERKESA NGA AK**

**2. Lista e stafit duhet te dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit per kete projekt i nënshkruar dhe vulosur nga OE b).Per stafin professional nga pika A. deri G. te dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri,diplomat, Kontratat e punës ose parakontrata per këtë projekt, licenca për gjeodet me validitet c).Per pikën H. dhe I., të dëshmohet me certifikata**

**sipas kërkesës dhe të jenë me validitet, Per piken J. Të dëshmohet me certifikata të lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftësim profesional. Për të gjithë punëtorët kërkohen kontratat e punës ose parakontratë për këtë projekt.**
**Autoriteti kontraktues mbante të drejtën e verifikimit te Certifikatave të kërkuara. AK është dashur ta refuzoj tenderin pa kërkuar informata shtesë pasi kompania ASCERT nuk është e akredituar për aftësim profesional nuk është qendër e aftësimit profesional.**

**Pretendimi 4**

**Mendimi i ESH**

4. Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional 9.1dhe 9.2, konkretisht pikën b për inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master, ku OE i rekomanduar për kontratë në listën e stafit si menaxher me vendim ka emëruar arkitektin Petrit Qarkagjiu CV e arkitektit në dosje të tenderit është e pa nënshkruar nga vet inxhinieri.

-Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të kërkesës së dosjes së tenderit dhe CV-së së arkitektit Petrit Qarkagjiu, sqaron se në mesin e kërkesave të dosjes së tenderit ka qenë që "për stafin profesional nga pika A deri G të dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri ". Pra, CV e inxhinierit të arkitekturës së OE të rekomanduar nuk është e nënshkruar konform kërkesës së FDT-së. Megjithatë, sipas nenit 38, par 9 të RrUOPP-së, AK mund të kerkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimit për situatë të tillë, (AK- përgjat ri vleresimit nuk e ka bere nje gje të tille), prandaj këte pretendim ankimore e kualifikojme si të bazuar.

Përgjigja jonë rreth mendimit te ESH

Nuk pajtohemi me medimin e ESH pasi që nuk e ka trajtuar drejt sipas LPP-së sepse kërkesa ka qenë e qartë nv DT dhe njoftimin për kontratv që CV të jetë nënshkruar nga vet inxhinieri OE i shpallur fitues ka dështuar ta plotësoj kerkeses nga AK që ta dorëzoj CV-në e nënshkruar nga vet inxhinieri **AK është dashur ta refuzoj tenderin pa kërkuar informata shtesë.**

| | | |
|---|---|---|
| CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 69 |

Pretendimi 5 i ESH

5. Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues,

Faqe 30 / 34

---

murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Osman Vitia në lëmin e ngrohjes ka dorëzuar diplomë të shkollës së mesme dhe nuk ka dorëzuar certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

- Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe diplomës së punëtorit Osman Vitia, sqaron se në këtë diplomë ceket Osman Vitia ka kryer shkollën e mesme të lartë profesionale, profili arsimor "montues i aparatit të nxemjes qëndrore". Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo diplomë është e shkollës së mesme profesionale është ekuivalente me kërkesën e AK-së. Për më tepër AK me rastin e ri vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkëngjitur certifikatën shtesë për punëtorin Osman Vitia, certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit professional. Pra, punëtori Osman Vitia ka përfunduar me sukses kursin "Instalues i ngrohjes qendrore". Andaj, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbush kërkesën e AK-së dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

  Si provë bashkangjitur me raport, gjeni certifikatën për punëtorin Osman Vitia.

**Përgjigja jonë rreth mendimit të pretendimit nr5 të ESH**

Nuk pajtohemi me mendimin e ESH pasi që nuk e ka trajtuar drejt sipas LPP-seë sepse kërkesa ka qen e qartë në DT dhe njoftimin për kontratë që 2. **Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE**. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur ngaOE b).Per stafin professional nga pika A. deri G. te deshmohen me CV te nenshkruar nga vet inxhinieri,diplomat, Kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt, licenca per gjeodet me validitet

c).Per piken H. dhe I., te deshmohet me certifikata sipas kerkeses dhe te jene me validitet, Per piken J. Te deshmohet me certifikata te lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional. Per te gjithe puntoret kerkohen kontratat e punes ose parakontrate per kete projekt.

Autoriteti kontraktues mbante drejtën e verifikimit te Certifikatave te kerkuara AK eshte dashur ta refuzoj tenderin pa kerku informata shtese

**Diploma në dosje tenderit e cila nuk është e lëshuar nga qendrat per aftësim profesional**




AK ka kërkuar informata shtesë kurse për neve për licensën e gjeldetit dhe vendimin e menaxherit nuk ka kërkuar është një diskriminim qe përkrah edhe AK edhe ESH dorëzon certifikatën qe është dashur te jetë dorëzuar para hapjes se ofertave .



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

QENDRA E AFTËSIMIT PROFESIONAL CENTAR ZA STRUČNO OSPOSOBLJAVANJU VOCATIONAL TRAINING CENTER

CERTIFIKATË - CERTIFIKAT - CERTIFICATE

MBI AFTËSIMIN PROFESIONAL
O STRUČNOM OSPOSOBLJAVANJU
ON PROFESSIONAL TRAINING

Osman Vitia I LINDUR ME /ROĐEN/BORN ON: 04/05/1967 NË/U/IN: Hajvali-Prishtinë

MË DATË/DATUM/ON DATE 19/08/2017 KA KRYER ME SUKSES KURSIN VJ/JE ZAVRŠIO/LA/JE KURS SA USPEHOM/HAS FINISHED

Instalues i Ngrohjes Qendrore

NIVELI I KUALIFIKIMIT SIPAS KKK/NIVO KVALIFIKACIJE PO NOK/QUALIFICATION LEVEL BY NQF III Tretë

KREDITË E ARRITURA/POSTIGNUTI KREDITI/CREDIT ACHIEVED 22

TRAJNERI Ing. Dip. i Hidr. Gani Bajraj UDHËHEQËSI/RUKOVODIJ/HEAD Zenullah Rrustemi

Vendi / Mesto / Place: PRISHTINË Data / Datum/Date 19/08/2017 Nr./Br./No: 484/2017

Pretendimi 6

Mendimi i ESH

6. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues, murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Arben Selimi në lëmin e hidroteknikës ka dorëzuar certifikatat në lëmin e ujësjellësit, d.m.th. nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK sepse mungon profili i kanalizimit dhe nuk e përmbush kërkesën në lëmin e hidroteknikës.

- Eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK në mesin e 8 punëtorëve ka kërkuar një punëtor të licencuar të hidroteknikës, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar punëtorin z. Arben Selimi dhe për të njëjtin është bashkangjitur një certifikatë për ujësjellës të lëshuar nga "Shkolla e Zanatit" në Mitrovicë dhe një certifikatë për zjarrfikës, të lëshuar nga

Faqe 31 / 34

Ministria e Shërbimeve Publike e Kosovës. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkangjitur certifikatën shtesë për punëtorin Arben Selimi, certifikatë e cila është lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit professional, ku Arben Selimi ka përfunduar me sukses trajnimin instalues i ujsjellsit dhe kanalizimit. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbushë kërkesën e AK-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.
Prove bashkangjitur me raport, gjeni certifikaten për punëtorin Arben Selimi.

**Përgjigja jonë rreth mendimit te pretendimit nr.6 të ESH**

Nuk pajtohemi me mendimin e ESH pasi qe nuk e ka trajtuar drejt sipas LPP-së sepse kerkesa ka qenë e qartë në DT dhe njoftimin per kontratë që 2. **Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE**. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur nga OE b).Per stafin professional nga pika A. deri G. te deshmohen me CV te nenshkruar nga vet inxhinieri,diplomat, Kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt, licenca per gjeodet me validitet c).Per piken H. dhe I., te deshmohet me certifikata sipas kerkeses dhe te jene me validitet, Per piken J. Te deshmohet me certifikata te lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional. Per te gjithe puntoret kerkohen kontratat e punes ose parakontrate per kete projekt.

Autoriteti kontraktues mbante drejtën e verifikimit te Certifikatave te kerkuara AK eshte dashur ta refuzoj tenderin pa kerkuar informata shtese **-certifikatës në dosje të tenderit për ujësjellës i mungon certifikimi për kanalizim**



hkolla e Zanati Technical School

ÇERTIFIKATË
CERTIFICATE

AMG INTERNATIONAL
ADVANCING THE MINISTRIES OF THE GOSPEL

të cilën vërtetohët se *Arben (Haki) Selimi* i lindur me: 02.04.1977
ka kryer me sukses kursin 5 javorë
Për aftësimin profesional nëShkollën e Zanatit Amg International
ë periodën kohore prej : 23/02/2004 deri më 26/03/2004 drejtimi: Ujësjellës
Projekt i përbashkët i trajnimit profesional AMG - REA Mitrovicë

this we verify that this trainee has finished with success a 5 week course in the
ssional skills at the Technical School at AMG-International during the recorded
eriod for the profession through the united project of professional training
AMG International and REA Mitrovica

UJËSJELLËS- PLUMBER

AK ka kërkuar informata shtesë kurse për neve për licensën e gjeodetit dhe vendimin e menaxherit nuk ka kërkuar është një diskriminim qe përkrah edhe AK edhe ESH dorëzon certifikatën qe është dashur te jetë dorëzuar para hapjes se ofertave ky është dokument krejt tjetër me atë te kërkuar ne DT.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

QENDRA E AFTËSIMIT PROFESIONAL/CENTAR ZA STRUČNO OSPOSOBLJAVANJE/VOCATIONAL TRAINING CENTER

## CERTIFIKATË KOMBËTARE PROFESIONALE NË:
## NACIONALNI STRUČNI CERTIFIKAT U:
## NATIONAL PROFESSIONAL CERTIFICATE IN:

| INSTALUES I UJSJELLSIT DHE KANALIZIMIT | III | 25 |
|---|---|---|
| Titulli i kualifikimit / Naziv kvalifikacije / Title of qualification | Niveli - KKK / Nivo - NOK / Level - NQF | Kredi / Kredit-a / Credit |

| ARBEN SELIMI | 1004322254 | PRISHTINË | PRISHTINË |
|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri / Ime Prezime / Name Surname | Nr. Personal / Lični Broj / Personal No | Vendlindja / Rodno mesto / Birthplace | Komuna / Opština / Municipality |

Ka përfunduar me sukses trajnimin në: / Sa uspehom završio /la obuku u: / Successfully finished Traning in:

MODULET / MODULIMA / MODULES

| | |
|---|---|
| HYRJE NË INSTALIMET E UJËSJELLSIT DHE KANALIZIMIT | MONTIMI I PAJISJEVE HIDROSANITARE |
| HAPJA E KANALEVE DHE VRIMAVE TË UJËSJELLSIT DHE KANA | NSTALIMI I RRJETIT TË JASHTËM TË UJËSJELLSIT |
| PËRGATITJA E GYPAVE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM | NSTALIMI I RRJETIT TË JASHTËM TË KANALIZIMIT |
| LLOGARITJET EKONOMIKE NË UJËSJELLËS DHE KANALIZIM | MONTIMI I POMPAVE TË UJIT NË RRJET. E UJËSJ. TË NDERTE. |
| INSTALIMET I RRJETIT TË BRENDSHËM TË UJËSJELLSIT | X |
| INSTALIMET I RRJETIT TË BRENDSHËM TË KANALIZIMIT | X |

Trajneri GANI BALAJ
Vendi / Mesto / Place: PRISHTINË

Udhëheqësi/Rukovod./Head ZENULLAH RRUSTEMI
Datë / Datum/Date 02/05/2018 Nr.Protokol. Br./No: 955/2018

Pretendimi nr.7

Mendimi i ESH

7. Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k. se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht kërkesën 3 që ka të bëjë me listën e pajisjeve teknike, ku është kërkuar të dëshmohet lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, kurse për automjetet që nuk regjistrohen duhet deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen duhet librezat e qarkullimit me validitet... dhe për këtë kërkesë, OE ankues potencon se OE i shpallur fitues në listën e pajisjeve ka dorëzuar kamionin Mercedes Atego 01-975-MR Kipper me validitet të regjistrimit deri me datë 17.06.2020, kurse hapja e tenderit është bërë me datë 19.06.2020 d.m.th. ky kamion nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK pasi që nuk ka validitet.

- Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e paisjeve teknike, ku perveç paisjeve tjera ka pershkruar gjithsej tre (3) kamion, ku dy nga ta në rastin e ofertimit kishin validitet për qarkullim rrugor. Për më tepër, eksperti shqyrtues sqaron se AK tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe professional, konkretisht në pozicionin b. ka kërkuar "Kamion min (2 copë)", rrjedhimisht OE i rekomanduar për dhënie e ploteson kërkesën e AK-së për dy kamion, pasi që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 19.06.2020, kurse OE i rekomanduar në listën e pajisjeve ka pasur "kamion Scani kiper dhe me targa 01-928-NF me regjistrim deri me datë 13.09.2020" dhe "kamion Volvo kiper me dy koka dhe me targa 01-968-HN me regjistrim deri me datë 09.07.2020". Pra, edhe pse kamioni "Mercedes Atego 01-975-MR Kipper" nuk ka pasur regjistrim, dy kamionët e cekur si më lartë e përmbushin kërkesën e AK-së që është "Kamion min (2 copë)".

  Si provë së bashku me raport gjeni kopjet e librezave të kamionëve si dhe marrëveshjen për shfrytëzim të komionit.




Kjo librezë qe e arsyeton ESH nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK pasi qe ne librezë i shkruan KOKE TERHEQESE e jo siç është kërkuar ne dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë KAMION.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k, se OE NPN "ALPING & ARBERI-NS" SHPK

nuk i plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht pikat sikur në ankesë. Më tej, OE ankues shton se AK ka kërkuar informata shtesë në bazë të vendimit të OSHP-së lidhur me certifikatat që ka lëshuar kompania AQSCERT. AK ka kërkuar informata shtesë lidhur me kompaninë AQSCERT për punëtorët e certifikuar: SELIM MALOKU, NAIM THAQI ARTON THAQI kanë certifikata nga kompania AQSCERT. Kompania AQSCERT ka dërguar programin për çfarë është e akredituar. AQSCERT është e akredituar si organizatë për sistemin e menaxhimit dhe sigurinë dhe shëndetin në punë. Nuk është qendër e licencuar për aftësim profesional siç është kërkuar në dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë. D.m.th. OE nuk e plotëson as këto kushte të kërkuara nga AK, ku AK nuk e ka eliminuar për këtë kërkesë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të ri vlerësimit të komisionit ri vlerësues, OE NPN ALPING DHE ARBERI-NS SHPK është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të përshkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 11.09.2020. Konkretisht i njëjti OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të të njëjtit OE është i panevojshëm në këtë fazë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë "GAMA ING" SHPK, nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht pikën h) Min. një punëtor i certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit. OE ankues shton se OE i rekomanduar në listën e stafit si punëtor për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit ka dorëzuar certifikatën me nr. AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, ku shkruan se z. Florin Imeri është aftësuar si koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Pra, OE ankues potencon se OE i rekomanduar ka dështuar në plotësimin e kushtit të kërkuar nga AK për një punëtor të certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e kantierit të ndërtimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të certifikatës me numër AQS/T/S 11002018 të lëshuar nga AQSCERT SHPK, sqaron se z. Florin Imeri ka marrë pjesë dhe ka kaluar me sukses testin final në trajnimin "Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", ku në mesin e temave kryesore të trajtuara ishin "përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kantier me synim rritjen e sigurisë në punë", si dhe tema tjera. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se certifikata e tillë e mbulon kërkesën e AK-së. Pra, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën që ka të bëjë me kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional 9.1dhe 9.2, konkretisht pikën b për inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose

master, ku OE i rekomanduar për kontratë në listën e stafit si menaxher me vendim ka emëruar arkitektin Petrit Qarkagjiu CV e arkitektit në dosje të tenderit është e pa nënshkruar nga vet inxhinieri.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të kërkesës së dosjes së tenderit dhe CV-së së arkitektit Petrit Qarkagjiu, në mesin e kërkesave të dosjes së tenderit ka qenë që "për stafin profesional nga pika A deri G të dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri ". Pra, CV e inxhinierit të arkitekturës së OE të rekomanduar nuk është e nënshkruar konform kërkesës së FDT-së. Megjithatë, sipas nenit 38, par 9 të RrUOPP-së, AK mund të kërkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimit për situatë të tillë, (AK- përgjatë ri vlerësimit nuk e ka bere një gjë të tille). Andaj, ky pretendim është i bazuar.

Kurse, në lidhje me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Osman Vitia në lëmin e ngrohjes ka dorëzuar diplomë të shkollës së mesme dhe nuk ka dorëzuar certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe diplomës së punëtorit Osman Vitia, sqaron se në këtë diplomë ceket Osman Vitia ka kryer shkollën e mesme të lartë profesionale, profili arsimor "montues i aparatit të nxemjes qëndrore". Pra, kjo diplomë është e shkollës së mesme profesionale është ekuivalente me kërkesën e AK-së. Për më tepër AK me rastin e ri vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkëngjitur certifikatën shtesë për punëtorin Osman Vitia, certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit profesional. Pra, punëtori Osman Vitia ka përfunduar me sukses kursin "Instalues i ngrohjes qendrore". Andaj, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbush kërkesën e AK-së dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht pikën j), ku është kërkuar minimumi 8 punëtor të certifikuar në lëminë e ndërtimit si saldues, armirues, murator, molerues, suvatim, ngrohje, hidroteknike dhe elektroteknike, kurse është kërkuar që të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga qendrat e licencuara për aftësim profesional dhe OE i shpallur fitues për punëtorin Arben Selimi në lëmin e hidroteknikës ka dorëzuar certifikatat në lëmin e ujësjellësit, d.m.th. nuk e plotëson

kushtin e kërkuar nga AK sepse mungon profili i kanalizimit dhe nuk e përmbush kërkesën në lëmin e hidroteknikës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK në mesin e 8 punëtorëve ka kërkuar një punëtor të licencuar të hidroteknikës, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar punëtorin z. Arben Selimi dhe për të njëjtin është bashkangjitur një certifikatë për ujësjellës të lëshuar nga "Shkolla e Zanatit" në Mitrovicë dhe një certifikatë për zjarrfikës, të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike e Kosovës. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me punëtorin në fjalë, ku i njëjti me datë 10.09.2020 është përgjigjur dhe ka bashkangjitur certifikatën shtesë për punëtorin Arben Selimi, certifikatë e cila është lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Qendra e aftësimit profesional, ku Arben Selimi ka përfunduar me sukses trajnimin instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues kjo certifikatë përmbushë kërkesën e AK-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP "CTA" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë GAMA ING SHPK nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht kërkesën 3 që ka të bëjë me listën e pajisjeve teknike, ku është kërkuar të dëshmohet lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, kurse për automjetet që nuk regjistrohen duhet deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen duhet librezat e qarkullimit me validitet... dhe për këtë kërkesë, OE ankues potencon se OE i shpallur fitues në listën e pajisjeve ka dorëzuar kamionin Mercedes Atego 01-975-MR Kipper me validitet të regjistrimit deri me datë 17.06.2020, kurse hapja e tenderit është bërë me datë 19.06.2020 d.m.th. ky kamion nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga AK pasi që nuk ka validitet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e paisjeve teknike, ku perveç paisjeve tjera ka pershkruar gjithsej tre (3) kamion, ku dy nga ta në rastin e ofertimit kishin validitet për qarkullim rrugor. Për më tepër, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe professional, konkretisht në pozicionin b, ka kërkuar "Kamion min (2 copë)", rrjedhimisht OE i rekomanduar për dhënie e ploteson kërkesën e AK-së për dy kamion, pasi që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 19.06.2020, kurse OE i rekomanduar në listën e pajisjeve ka pasur "kamion Scani kiper dhe me targa 01-928-NF me regjistrim deri me datë 13.09.2020" dhe "kamion Volvo kiper me dy koka dhe me targa 01-968-HN me regjistrim deri me datë 09.07.2020". Pra, edhe pse kamioni "Mercedes Atego 01-975-MR Kipper" nuk ka pasur regjistrim, dy kamionët e cekur si më lartë e përmbushin kërkesën e AK-së që është "Kamion min (2 copë)".

Në lidhje me pretendimin e OE ankues NNP"CTA"SHPK, se është eliminuar nga AK me arsyetimin se tek

kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht te stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktiv, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues **duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës**. Si dhe arsye e dytë e eliminimit nga AK është se tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional që ka të bëjë me licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar, e cila është vërtetuar edhe në mendimin e ekspertit dhe vendimin e OSHP-së gjatë periudhës sa ka qenë lënda në OSHP.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK tek kërkesa 2 e pikës 9.1&9.2 të dosjes së tenderit, në mënyrë specifike ka kërkuar:

> "*Kerkesa 2. Stafi Profesional a) Min. Nje Inxhiner i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeqar ose master,* ***Te caktohet edhe si menagjer per kete projekt,***"

Kurse, OE ankues si menaxher të projektit e ka caktuar Zija Morina me kualifikim **inxhinier i kualifikuar i ndërtimtarisë, dega ndërtimtari, drejtimi konstruktiv**, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës nuk ka caktuar si menaxher të projektit inxhinierin e arkitekturës siç është kërkuar nga AK.

Kurse, në lidhje me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me arsyetimin e eliminimit pas ri vlerësimit të ofertave kundrejt parashtruesit të ankesës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit që ka të bëjë me licencën e gjeodetit, ky pretendim është trajtuar sipas vendimit PSH.nr.484/20, ku është potencuar se: "*OE edhe tani ankues, ka ngarkuar licencen e gjeodetit z.Muzafer Mustafa ne plateformen e – prokurimi, ku kjo licence ishte dhene me daten 27.03.2024, me afat skadimi 25.03.2019, kurse perms ankese se parashtruar OE ankues ka bashkangjitur licencen e pot e njejti gjeodet, me dat te dhenjes 27.03.2019, dhe me afat skadimi 25.03.2024*". Pra, pretendimi i ankuesit ishte trajtuar si i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues NNP"CTA"SHPK, ku cek dispozitat e nenit 31të RRUOPP-së që kanë të bëjnë me validitetin e ofertave.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim e ka kontestuar rekomandimin për dhënie të kontratës të datës 11.09.2020.AK/ Komuna Lipjan ka aprovuar kërkesën e datës 15.09.2020, dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se operatorëve ekonomik nuk i është kërkuar vazhdimi i validitetit dhe sigurimi i ofertave. Pastaj, OE ankues përsëri e ka kontestuar propozimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës 21.09.2020, përmes kërkesës për ri shqyrtim. AK, me datën 23.09.2020, aprovon kërkesën për ri shqyrtim dhe lë në fuqi vendimin e datës 11.09.2020, për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK me datën 22.09.2020 (rreth 5 dite pas skadimit të ofertave) ka kërkuar nga operatorët ekonomik zgjatjen validitetit dhe sigurimit të tenderit. Sipas nenit 31 të RrUOPP-se, AK-të janë të obliguara që para datës së skadimit të kërkojnë nga ofertuesit zgjatjen e validitetit

dhe sigurimit të tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK duhet që këtë aktivitet të prokurimit ta anuloj në tërësi pasi që operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit nuk janë trajtuar në mënyrë të drejt sipas parimeve të Prokurimit Publik. Rrjedhimisht, përveç mos respektimit të procedurës nuk janë respektuar në tërësi edhe dispozitat e LPP-së, përkatësisht nuk është respektuar neni 7 dhe 59 i LPP-së. Andaj, në bazë të nenit 62 të LPP-së duhet që ky aktivitet i prokurimit të anulohet për shkak te shkeljeve të ligjit të cilat tanimë kanë ndodhur.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK– Kuvendi Komunal-Lipjan.

1x1 OE ankues - NNP "CTA" sh.p.k-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.